

Rreziqet Bankare

Dr. Elvin MEKA

7

Natyra e rreziqeve bankare

Që nga vitet '60 sistemi bankar botëror është përballur me natyra të ndryshme rreziqesh:

Vitet '60:

- Interesi i bankave ishte përdorimi efektiv i fondeve, me qëllim manaxhimin efektiv të detyrimeve.**

Natyra e rreziqeve bankare

Vitet '70:

- **Banking i thjeshtë, konkurrencë e ulët, rreziqe të natyrës operacionale. Gjatë mesit të viteve '70 deri në fund të tyre, fokusi ishte manaxhimi i rrezikut të normës së interesit dhe likuiditetit. Fillesat e ALM-së.**

Vitet '80:

- **Liberalizim dhe derregullim i tregut dhe konkurrencë e shtuar. Vëmendje e shtuar ndaj ALM-së dhe rreziqeve respektive.**

Natyra e rreziqeve bankare

Vitet '90:

- **Liberalizim i mëtejshëm i tregut dhe rritje e konkurrencës. Përfshirje e operacioneve të zërave jashtë bilancit në modelet e manaxhimit të rreziqeve. Shtrirja e mëtejshme e aktivitetit bankar në zërat jashtë bilancit dhe aktivitete jobankare, duke rritur kompleksitetin e manaxhimit të rreziqeve, përtej një ALM-jë të thjeshtë.**

Natyra e rreziqeve bankare

Vitet 2000:

- **Përdorimi i theksuar i inxhinierisë financiare, për gjenerimin e produkteve të strukturuarra e të sofistikuarra dhe transferimi i rreziqeve drejt tregut të letrave me vlerë (*securitization*). Përdorimi masiv i produkteve derivate për manaxhimin e rreziqeve të ndryshme.**

Natyra e rreziqeve bankare

Për të gjithë bankat, pavarësisht nga kompleksiteti i organizimit të tyre (si banka të thjeshta apo konglomerate komplekse fnanciare), qëllimi kryesor është maksimizimi i fitimeve dhe krijimi i vlerës së shtuar për aksionerët.

Këto qëllime arrihen nëpërmjet manaxhimit të rreziqeve.

Përkufizimi i rrezikut

Rreziku përkufizohet si luhatshmëria apo devijimi standard (rrënja katrore e variancës) i rrjedhës neto të parave (net cash flow) të shoqërisë.

Llojet e rreziqeve

Llojet e rreziqeve bankare:

- **Besueshmërisë (Credit),**
- **Palëve të treta (Counterparty),**
- **Likuiditetit/financimit (Liquidity/funding risk),**
- **Shlyerjes ose pagesave (Settlements or payments risk),**
- **Tregut ose çmimit (Market or price risk, including – currency risk – interest rate risk)**
- **Kapitalit ose Levës (Capital or gearing risk),**
- **Operacional (Operational),**
- **Shtetëror dhe Politik (Sovereign and political risk).**

Llojet e rreziqeve

Rreziku i Besueshmërisë dhe Palëve të Treta

Nënkupton rrezikun që një hua nuk mund të kthehet (rekuperohet) ose paraqet vonesa në ripagim.

Është një formë e rrezikut të palëve të treta (counterparty).

Rreziku i palëve të treta lidhet më shumë me tregtimin e instrumenteve financiare.

Përbën mbi 80% të rreziqeve bankare, pasi pjesa më e madhe e bilancit të bankave përbëhet nga huatë.

Llojet e rreziqeve

Rreziku i Likuiditetit ose Financimit

Nënkupton rrezikun që banka nuk do të përmbushë detyrimet e saj në momentin e kërimit të tyre, ose kur ato maturohen.

Ky rrezik mund të eliminohet duke realizuar një përputhje të plotë të maturimit të aktiveve me ato të pasiveve, por kjo do të jetë pa përfitim për bankat, pasi bankat një nga funksionet thelbësore kanë transformimin e aktiveve (detyrimet afatshkurtra në aktive afatgjata).

Llojet e rreziqeve

Rreziku i Shlyerjes ose pagesave (Herstatt)

Nënkupton rrezikun që njëra palë nuk do të kryejë pagesën që detyrohet ose nuk do të dorëzojë mjetet financiare që detyrohet.

Ky rrezik mund të përfshijë rrezikun e besueshmërisë ose atë të likuiditetit.

Përveç diferencave kohore midis tregjeve financiare, ky rrezik është i pranishëm (shkaktohet) edhe brenda të njëjtit treg, dhe pasqyrohet në pagesat ndërbankare (brenda sistemit të pagesave të një vendi).

Llojet e rreziqeve

Rreziku i Shlyerjes ose pagesave (Herstatt)

Ky rrezik mund të reduktohet në disa mënyra:

- **Aplikimi i parimit të “*NETTING*”:** Banka bën një pagesë neto ndaj një pale me të cilën hyn në transaksion. Teknikisht shkëmbehen shumë më pak fonde fizike. Gjithsesi nuk redukton shumë rrezikun, pasi nëse një bankë ka vështirësi likuiditeti ky problem transmetohet në sistem (*rreziku sistemik*).

Llojet e rreziqeve

Rreziku i Shlyerjes ose pagesave (Herstatt)

Ky rrezik mund të reduktohet me disa mënyra:

- **Aplikimi i sistemit RTGS (*Real Time Gross Settlement*). Sipas këtij sistemi, detyrimet e palëve (bankave) shlyhen në llogarinë që banka ka me bankën qendrore (që funksionon si **CLEARING HOUSE**), për madhësinë bruto të detyrimit, në momentin e krijimit të detyrimit dhe jo në fund të ditës (sipas sistemit “netting”).**

Llojet e rreziqeve

Rreziku i Tregut ose Çmimit

Ky rrezik lidhet me instrumentet që tregtohen në tregjet financiare dhe lidhet me luhatjet e çmimeve të këtyre instrumenteve në treg.

- **Rreziku sistematik (ose i përgjithshëm) lidhet me ndryshimet e çmimeve të të gjithë instrumenteve, si pasojë e ndryshimeve në politikat ekonomike.**
- **Rreziku josistematik (specifik) lidhet me luhatjen e çmimit të instrumentit, që lidhet me ndonjë ngjarje që i ndodh emetuesit të këtij instrumenti.**

Llojet e rreziqeve

Rreziku i Tregut ose Çmimit

Llojet kryesore:

- **Rreziku i normës së interesit. Krijohet nga mospërputhja e normave të interesit. Reduktohet nëpërmjet zbatimit të ALM-së.**
- **Rreziku i kursit të këmbimit. Krijohet nga luhatja e kurseve të këmbimit të monedhave në të cilat ushtron aktivitetin banka. Ky rrezik reduktohet nga përdorimi i një monedhe të vetme (psh: EURO).**

Rreziqet Bankare

7

Llojet e rreziqeve

Rreziku i Kapitalit ose Levës Financiare

Përdorimi i lartë i levës financiare nga banka nënkupton një tolerancë më të vogël, lidhur me rreziqet që banka merr përsipër.

Sipas parimeve të Bazelit, bankat që marrin më shumë rrezik përsipër duhet të paguajnë më shumë kapital. Bankat priren të rrisin përdorimin e levës, me qëllim rritjen e përfitueshmërisë për aksionerët e tyre.

Rreziqet Bankare

7

Llojet e rreziqeve

Rreziku i Kapitalit ose Levës Financiare

$$\mathbf{ROE = ROA \times (\text{gearing multiplier})}$$

ku:

ROE – të ardhura neto/kapitali i vet

ROA - të ardhura neto/aktive

Gearing Multiplier: aktive/kapitali i vet

Meqë ROA përgjithësisht është e vogël, ROE mund të rritet duke rritur levën financiare.

Llojet e rreziqeve

Rreziku i Kapitalit ose Levës Financiare

Rreziku i kapitalit rrjedh dhe nga rreziqet e tjera si: rreziku i besueshmërisë, i tregut ose i likuiditetit.

Financuesit aktualë ose të mundshëm të bankës shqyrtojnë dy raporte:

- Raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit:

Kapital/Aktive të ponderuara me rrezik (RWA)

- Raportin e levës financiare:

Borxh/Kapital i Vet

Llojet e rreziqeve

Rreziku Operacional

Rreziku operacional përkufizohet nga BIS si:

“The risk of direct or indirect loss resulting from inadequate or failed internal processes, people, and systems, or from external events.” (BIS, 2001, p. 27).

Matja e këtij rreziku është tepër e vështirë.

Llojet e rreziqeve

Rreziku Operacional

Llojet kryesore:

- **Kapitali fizik: dëmtimet e ndryshme të kapitalit fizik, problemet me sistemin kompjuterik, manaxhimin e të dhënave, ekzekutimin e transaksioneve (dështimet teknologjike).**
- **Kapitali njerëzor: gabimet njerëzore, problemet shëndetsore dhe të sigurisë fizike, praktikat e papërshtatshme të punësimit, mashtrimet nga stafi.**

Llojet e rreziqeve

Rreziku Operacional

Llojet kryesore:

- **Problemet ligjore: Problemet e procedimit ligjor të bankës nga klientët, punonjësit, apo personat e lidhur me bankën.**
- **Mashtrimi: Mund të jetë i brendshëm ose i jashtëm.**

Llojet e rreziqeve

Rreziku Shtetëror dhe Politik

Rreziku Shtetëror i referohet rrezikut që një qeveri nuk përmbush detyrimin e shlyerjes së borxhit kundrejt një banke apo agjencie qeveritare.

Është një formë e veçantë e rrezikut të besueshmërisë, por ky rrezik nuk mund të aktivizojë instrumente rekuperuese ose kompensuese për ripagesën e fondeve të huajtura.

Ky rrezik është problematik në drejtim të zbatueshmërisë së kontratës së huasë.

Ky rrezik lidhet me riskedulimin apo mosnjohjen e borxhit (huasë së pashlyer).

Llojet e rreziqeve

Rreziku Shtetëror dhe Politik

Rreziku Politik përkufizohet si ndërhyrja e shtetit në aktivitetin e një shoqërie vendase apo të huaj.

Bankat mund të jenë subjekt i taksave të larta vendosjes së regjimeve të kontrollit të kurseve të këmbimit apo normave të interesit, ose shtetëzimeve.

Të gjithë bizneset janë të ekspozuara kundrejt këtij rreziku, por bankat janë shumë të prekshme ndaj këtij rreziku, për shkak të pozicionit dhe rolit kritik që ato kanë dhe luajnë brenda sistemit financiar.

Analizat e GAP-eve

Analiza e GAP-eve është teknika më e njohur e ALM-së, që normalisht përdoret për manaxhimin e rrezikut të normës së interesit dhe të likuiditetit.

GAP-i është diferenca midis aktiveve dhe detyrimeve të ndjeshme ndaj interesave – RSA dhe RSL (me interesa variabël) për një interval të caktuar kohe. Në analizën e GAP-eve, çdo kategori aktivi apo detyrim i bankës klasifikohet sipas datës në të cilën aktivi rivlerësohet dhe në “shporta kohore”: overnight – 3 muaj, >3–6 muaj, >6–12 muaj e në vijim.

Analizat e GAP-eve

Analistët përlllogarisin GAP-e shtesë (incremental) dhe kumulative (cumulative).

Një aktiv apo detyrim është i ndjeshëm ndaj normës së interesit kur rrjedha e tij e parasë ndryshon në të njëjtin drejtim me ndryshimin nënormën e interesit.

GAP-i është pozitiv nëse $RSA > RSL$ dhe e anasjellta.

Raporti i GAP-it llogaritet: RSA/RSL . Nëse ky raport është 1 kemi përputhje të plotë të ndjeshmërisë së aktiveve dhe detyrimeve dhe GAP-i është zero.

Analizat e GAP-eve

Bankat përgjithësisht kanë një GAP pozitiv, dmth RSA tejkalojnë RSL, pasi bankat marrin hua fonde me afat të shkurtër dhe japin hua me afate të gjata; aktivet e tyre maturohen më vonë se detyrimet.

Nëse GAP-i është pozitiv atëherë një rritje e normave të interesit rrit kthimet nga aktivet më shumë sesa kosto e detyrimeve dhe anasjelltas.

Analizat e GAP-eve

GAP-et e likuiditetit

Objektivi i manaxhimit të rrezikut të likuiditetit është shmangia e situatave kur aktivet likuide neto janë negative.

(Net Liquid Assets = Liquid Financial Assets – Current Liabilities).

Për këtë qëllim përdoret analiza e GAP-eve të likuiditetit:

GAP-i i likuiditetit = Aktive likuide neto – detyrimet variabël.

Analizat e GAP-eve

GAP-et e likuiditetit

Zërat e bilancit vendosen në një shkallë kohore, sipas momentit të rrjedhave hyrëse apo dalëse të parasë nga këto zëra.

Pozicionet e pabalancuara akumulohen gjatë gjithë horizontit kohor dhe japin pozicionin e plotë të disbalancës së likuiditetit për bankën.

Banka mund të monitorojë në çdo moment sasinë e fondeve likuide që ajo do të ketë në dispozicion në të ardhmen, pa likuiduar apo shitur aktive, para momenteve të nevojshme.

Rreziqet Bankare

7

Analizat e GAP-eve


Table 3.4 Liquidity Funding – Maturity Ladder Approach (£000)*

	Week 1	Week 2	Week 3	Week 4
<i>Cash inflows</i>	12 000	10 000	10 000	8 500
Assets (week they mature)	1 500	8 000	2 000	1 000
Sales planned	10 000	1 000	3 000	2 500
Agreed credit lines	500	1 000	5 000	6 000
<i>Cash outflows</i>	11 700	9 500	10 700	8 900
Liabilities due	7 000	3 000	9 000	4 000
Contingent liabilities (e.g. credit lines)	4 500	6 000	1 500	4 500
Unplanned cash outflows	200	500	200	400
Net funding needs	–300	–500	700	400
Cumulative net funding needs	–300	–800	–100	300

Rreziqet Bankare

7

Analizat e GAP-eve



Procesi i manaxhimit të rreziqeve


Procesi i manaxhimit të rreziqeve kalon në 4 faza:

- **Identifikimi,**
- **Matja,**
- **Trajtimi (adresimi),**
- **Zbatimi,**
- **Vlerësimi.**

Rreziqet Bankare

7

Procesi i manaxhimit të rreziqeve



Procesi i manaxhimit të rreziqeve

IDENTIFIKIMI: Kërkon njohuri të thella mbi produktet financiare dhe kompetencë në identifikimin e rreziqeve.

MATJA: Synon përkthimin në terma sasiorë të rreziqeve të identifikuara. Kërkon aftësi dhe kryerjen e analizave të thelluara statistikore.

Procesi i manaxhimit të rreziqeve

TRAJTIM: Rreziqet mund të trajtohen në këto mënyra:

- 1. SHMANGIA** (mosangazhimi në investime dhe produkte me shumë rrezik, ose për të cilët rreziku nuk kuptohet mirë).
- 2. REDUKTIMI** (merret përsipër vetëm një pjesë e rrezikut – përdorimi i kolateralit).

Procesi i manaxhimit të rreziqeve

3.PRANIMI (pjesë e strategjisë së biznesit; tipike për investimet në aktive me rrezik të ulët ose duke i diversifikuar investimet e produktet).

4.TRANSFERIMI (rrezikutransferohet në një bankë tjetër ose në një shoqëri sigurimi).

Procesi i manaxhimit të rreziqeve

ZBATIM: Pas hartimit të strategjisë së manaxhimit të rrezikut, kalohet në zbatim, duke angazhuar:

- **Specialistë,**
- **Infrastrukturë IT dhe modele manaxhimi e monitorimi të rreziqeve.**

Procesi i manaxhimit të rreziqeve

VLERËSIMI: Verifikohet nëse rreziqet aktuale me të cilat përballet banka janë brenda parametrave të përcaktuara në strategji ose jo.

Manaxhimi i rreziqeve

Rreziku i Besueshmërisë dhe Palëve të Treta

Manaxhimi i këtij rreziku lidhet ngushtësisht me manaxhimin e portofolit të huave të bankës, në aspektet e mëposhtme:

- 1. Manaxhimi i portofolit të huave,**
- 2. Funkcionet dhe operacionet e huadhënies,**
- 3. Cilësia e portofolit të huave,**
- 4. Portofoli i huave me probleme,**
- 5. Politikat e manaxhimit të rrezikut të besueshmërisë:**
 - i. Reduktimi i rrezikut të besueshmërisë,**
 - ii. Klasifikimi i aktiveve,**
 - iii. Politika e provigjonimit të huave.**

Manaxhimi i rreziqeve

Rreziku i Besueshmërisë dhe Palëve të Treta

1. Manaxhimi i portofolit të huave

Ky aspekt diktohet nga rregullatorët dhe formësohet në politikat dhe praktikat e brendshme të çdo banke, që përcaktojnë:

- **Kufizimet mbi totalin e huave të disbursuara (në raport me totalin e depozitave, kapitalit, aktiveve, etj).**
- **Kufizimet gjeografike në huadhënie.**
- **Përqendrimin e huave (ekspozimet) ndaj klientëve, pesonave të lidhur, sektorit të ekonomisë, etj.**

Manaxhimi i rreziqeve

Rreziku i Besueshmërisë dhe Palëve të Treta

2. Funkcionet dhe operacionet e huadhënies

Huaja bankare duhet të plotësojë tre objektiva:

- **Huadhënia duhet të jetë e përgjegjshme dhe huatë të jenë të ripagueshme,**
- **Fondet duhet të investohen me fitim, për të rritur vlerën e aksionerëve dhe mbrojtur depozituesit,**
- **Të përmbushen nevojat për hua të agjentëve ekonomikë dhe individëve.**

Manaxhimi i rreziqeve

Rreziku i Besueshmërisë dhe Palëve të Treta

3. Cilësia e portofolit të huave

Bankat normalisht angazhohen në një proces të vazhdueshëm rishikimi të cilësisë së:

- **Huave për bizneset dhe individët,**
- **Huave ndërbankare,**
- **Zërave jashtë bilancit,**

pasi nga ky proces banka përfton një panoramë të plotë të profilit dhe prioriteteve të saj të biznesit, sikundër dhe informacione mbi natyrën e rrezikut të besueshmërisë që ajo pret apo po merr përsipër në vijim.

Manaxhimi i rreziqeve

Rreziku i Besueshmërisë dhe Palëve të Treta

3. Cilësia e portofolit të huave

Zakonisht ky proces përpiqet t'i japë përgjigje pyetjeve të mëposhtme:

- **Kujt?**
- **Çfarë?**
- **Sa gjatë?**

Manaxhimi i rreziqeve

Rreziku i Besueshmërisë dhe Palëve të Treta

4. Portofoli i huave me probleme

Inkuadrohet në kuadër të procesit të klasifikimit të aktiveve.

Huatë me probleme janë ato hua që nuk gjenerojnë të ardhura (zakonisht ato hua që nuk paguajnë prej 90 ditësh ose më shumë).

Portofoli i huave me probleme pasqyron cilësinë e portofolit të huave në përgjithësi.

Manaxhimi i rreziqeve

Rreziku i Besueshmërisë dhe Palëve të Treta

5. Politikat e manaxhimit të rrezikut të besueshmërisë

Tre politika:

- 1. Reduktimi i rrezikut të besueshmërisë (ekspozimet e mëdha, huadhënia ndaj personave të lidhur, ekspozimi i tepërt),**
- 2. Klasifikimi i aktiveve (standarde, në ndjekje, nënstandarde, të dyshimta, të humbura),**
- 3. Provigjonimi i humbjeve (lidhet me klasifikimin e aktiveve).**